

PROGRAMI I PËRPUTHSHMËRISË I OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR

[Albgaz Sh. a]

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky Program Përputhshmërie (këtu dhe më poshtë Programi) i operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror (këtu dhe më poshtë OST) vendos kushtet për ndarjen dhe pavarësinë e OST sipas Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror dhe ka për qëllim të përcaktojë masat që duhet të ndërmerren për të siguruar përjashtimin e sjelljeve diskriminuese në aktivitetet e OST, si dhe të përcaktojë detyrimet specifike të punonjësve të OST për të përmbushur objektivat e përcaktuara në këtë dokument dhe kërkesat për zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi.

2. Ky Program ka si qëllim të sigurojë:

2.1. Ndarjen e duhur dhe pavarësinë e OST;

2.2. Të shmangë sjelljet diskriminuese të OST ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror (këtu dhe më poshtë pjesëmarrësit) dhe përdoruesve të rrjetit;

2.3. Parandalimin e aksesit tek kushtet koncesionare në sistemin e transmetimit të cilat duhet të ofrohen për pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit;

2.4. Prezantimi i një mekanizmi për zbatimin e këtij Programi dhe përcaktimi i detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST në lidhje me këtë; dhe

2.5. Prezantimi i një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

3. Të gjitha termat e këtij Programi duhet të përdoren në kuptimin e përshkruar në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.

II. STATUSI LIGJOR DHE STRUKTURA E KORPORATËS SË OST

4. Emri i Shoqërisë është “Albgaz Sh. a”

Shoqëria është një person juridik Shqiptar që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, sipas parashikimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar (“Ligji për Shoqëritë Tregtare”).

5. Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”) për llogari të Republikës së Shqipërisë, me adresë në “Bulevardin Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri.

6. Sistemi me dy nivele

12.1 Vendimmarrja dhe administrimi i Shoqërisë është strukturuar sipas sistemit me dy nivele, në përputhje me Pjesën V, Titulli IV, Kapitulli III i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

12.2 Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a. Asambleja e Përgjithshme;
- b. Këshilli Mbikëqyrës; dhe
- c. Administratori.

a. Asambleja e Përgjithshme;

(Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë)

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë, për zhvillimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
- b. Miratimin e strategjisë dhe planeve financiare të Shoqërisë, si dhe të çdo ndryshimi të tyre;
- c. Ndryshimin e Statutit;
- d. Zgjedhjen, shkarkimin dhe pranimin e dorëheqjes të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe miratimin e skemës së shpërblimit të tyre;

- e. Zgjedhjen dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të likuiduesve.
- f. Miratimin e pasqyrave financiare, dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë, dhe ndryshimeve në politikat kontabële të Shoqërisë;
- g. Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- h. Pjesëtimin, tërheqjen, anulimin, riblerjen dhe rifitimin e aksioneve;
- i. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- j. Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedura të tjera kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- k. Transformimi (duke përfshirë bashkimin, ngrirjen, ndarjen, ndryshimin e formës ligjore apo riorganizime të tjera të shoqërive), prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë;
- l. Kërkimin nga Administratori apo Këshilli Mbikëqyrës për të dhënë informacion apo për të raportuar mbi çdo çështje lidhur me Shoqërinë; dhe
- m. Çështje e problematika të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare apo në këtë dokument.

13.3 Asambleja e Përgjithshme do të ketë të drejtë të japë miratimin e saj paraprak mbi çështjet dhe veprimet vijuese:

- a. Hapjen apo mbylljen e një shoqërie të kontrolluar apo shkrirjen e një interesi të Shoqërisë në një shoqëri të kontrolluar apo entitet tjetër, ose hyrjen në, ndryshimin apo përfundimin e çdo joint venture, partneriteti, konsorciumi, apo marrëveshjeje të ngjashme;
- b. Zvogëlimin, zgjerimin dhe çdo modifikim tjetër i objektit të aktivitetit ose qëllimit të Shoqërisë apo përfshirjen e Shoqërisë në çfarëdo aktivitetit pa lidhje me sa më lart;
- c. Veprime sipas nenit 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, marrje pjesë në, ndryshimin apo zgjidhjen e kontratave apo e çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet Shoqërisë, nga njëra anë, dhe Administratorit, anëtarit(ëve) të Këshillit Mbikëqyrës, apo çdo pale të tretë, e cila konsiderohet se

- është e lidhur me Administratorin e Shoqërisë apo anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës sipas neneve 13 (2) dhe (3) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nga ana tjetër;
- d. Lidhjen, ndryshimin apo zgjidhjen e një marrëveshjeje huaje apo kredie (të marra apo të dhëna), ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të Shoqërisë që e tejkalon shumën prej 10.000.000 EURO për çdo veprim dhe 20.000.000 EURO kumulative për një vit;
 - e. Heqjen dorë nga nga një e drejtë me një vlerë nominale që tejkalon 300.000 EURO për çdo veprim ose që tejkalon shumën totale 500.000 EURO në një vit të caktuar financiar;
 - f. Të miratojë paraprakisht, shitjen dhe cdo lloj disponimi të aseteve të paluajtshme ku vlera e një kontrate e lidhur me një subjekt është mbi 300,000 EURO .
 - g. Të miratojë paraprakisht shitjen apo cdo formë disponimi të aseteve të luajtshme nëse vlera e një kontratë është mbi 300,000 EURO ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është mbi 700.000 EURO brenda një viti financiar.
 - h. Çdo çështje dhe/ose veprim tjetër për të cilin Asambleja e Përgjithshme ka rezervuar, me vendim të posaçëm, të drejtën e miratimit paraprak

Procedurat e Asamblesë së Përgjithshme

- 15.1 Asambleja e Përgjithshme mund të përcaktojë rregulla për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në asamble. Këto rregulla miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e tre të katërtave të kapitalit, të përfaqësuar në mbledhje, sipas parashikimeve të ligjit.
- 15.2 Asambleja e Përgjithshme cakton një kryetar për përgatitjen dhe drejtimin e mbledhjes, si edhe një sekretar.
- 15.3 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
- 15.4 Procesverbali i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Asamblesë tregon: datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë, numrin e aksioneve me të cilat është votuar dhe kuorumi i arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e Asamblesë, një përmbledhje të

debateve, tekstin e vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatin e votimit. Proces – verbali firmoset nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për ruajtjen e vendimeve dhe proces-verbaleve të mbledhjes.

15.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të zhvillohen edhe nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës, ose me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të identifikuar dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimin e të marrin pjesë aktivisht në të, në përputhje me kërkesat e ligjit të zbatueshëm; në këtë rast Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhen si Kryetari ashtu edhe Sekretari i mbledhjes.

15.6 Vendi i zgjedhur (apo mënyra e zhvillimit, nëse është e zbatueshme), data dhe koha e organizimit të kësaj mbledhjeje, si edhe programi i mbledhjes në fjalë do t'u njoftohen aksionarëve dorazi, nëpërmjet postës, postës elektronike, apo faksit jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Nëse mbledhja zhvillohet nëpërmjet komunikimeve elektronike ajo do të konsiderohet si e mbajtur në kohën dhe selinë e Shoqërisë. Procedura e njoftimit të aksionereve dhe procedurat e takimit të Asamblesë do të jenë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për shoqëritë aksionare.

b. Këshilli Mbikëqyrës

(Këshilli Mbikëqyrës është organi i shoqërisë i ngarkuar me mbikëqyrjen e veprimtarisë së Administratorit sipas politikave të Shoqërisë, neneve të këtij Statuti dhe të legjislacionit të zbatueshëm)

Këshilli Mbikëqyrës ka për detyrë të:

- a. Të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave të shoqërisë.
- b. Vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë nga Administratori; dhe
- c. Përgatisë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme masa të cilat janë në kompetencën e kësaj të fundit; të rekomandojë vendime për t'u marrë nga Asambleja e Përgjithshme, dhe të ekzekutojë vendimet e saj.

16.3 Këshilli Mbikëqyrës është kompetent të:

- a. Thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë kjo konsiderohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë dhe menjëherë pas verifikimit të rrethanave të parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 136 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- b. Sigurojë që Shoqëria zbaton ligjet dhe standardet e zbatueshme të kontabilitetit;
- c. Shqyrtojë librat e Shoqërisë, dokumentet dhe asetet;
- d. Sigurojë që pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raporti i performancës së Shoqërisë të përgatiten në mënyrë të rregullt nga Administratori, dhe që ky i fundit të përmbushë çdo detyrim tjetër ligjor apo statutor për raportim apo publikim. Këto dokumente duhen miratuar e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për t'i paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me arsyet e miratimit dhe një përshkrim të mënyrave se si është monitoruar administrimi gjatë vitit financiar; dhe
- e. Sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrave të kryhet të paktën çdo vit nga një ekspert kontabël i pavarur dhe që raporti i auditorit drejtuar Asamblesë së Përgjithshme t'i jetë vënë në dispozicion çdo anëtari të Këshillit Mbikëqyrës. Raporti i Këshillit sipas gërmës së mëparshme (d) duhet të përmbajë gjithashtu mendimin e Këshillit mbi raportin e auditimit.
- f. Të krijojë komitete të përhershme apo të posaçme, për çështje të ndryshme operacionale të shoqërisë;
- g. Të krijojë komitetin e posacëm të auditimit të brendshëm, në të cilin bëjnë pjesë jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
- h. Të kërkojë informacion dhe të iniciojë procese llogaridhënie për cdo rast që e sheh të arsyeshme lidhur me vendimet e marra nga Administratori, ose aktivitetin e shoqërisë apo divizioneve e departamenteve të tjera të saj.
- i. Të miratojë strukturën organizative dhe strukturën e personelit të Shoqërisë, si dhe ndryshimin e tyre;
- j. Të emërojë dhe të lirojë nga detyra Administratorin e Shoqërisë.
- k. Të miratojë strukturën e drejtorisë së auditit të brendshëm, të shoqërisë dhe të

emërojnë drejtorin e anëtarët e saj.

- l. Të miratojë planin vjetor të investimeve, përfshirë marrëveshjet në lidhje me kapacitetet e interkonjeksionit ndërkufitar, shërbimet e transmetimit, depozitimit dhe të impianteve apo të shpërndarjes së gazit natyror.
- m. Të miratojë hyrjen në një marrëveshjeje huaje apo kredie (të marra apo të dhëna), ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të Shoqërisë deri në shumën prej 10.000.000 EURO;
- n. Të japë miratimin paraprak për blerjen e asetëve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 Euro.
- o. Të miratojë paraprakisht shitjen apo cdo formë disponimi të asetëve të paluajtshme të Shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 EURO, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 EURO.
- p. Të miratojë paraprakisht shitjen e asetëve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 EURO, ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 EURO brenda një viti financiar.
- q. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në planin financiar të Shoqërisë me kërkes nga Administratori dhe të marrë aprovimin nga Asambleja për ndryshimet që janë me të larta se 25% (njëzet e pesë përqind) e vlerës fillestare të planit financiar të vitit ushtrimor.
- r. Të miratojë paraprakisht ndryshimet në planin financiar të Shoqërisë me kërkes nga Administratori kur ka ndryshim të vlerës fillestare më pak se 25% (njëzet e pesë përqind).
- s. Të miratojë paraprakisht propozimet e Administratorit për donacione, sponsorizime, financimin e projekteve sociale, kulturore dhe bamirësie.
- t. Përveç rasteve specifike të përcaktuara në gjurmën l, m,n,o,p të pikës 3 neni 16, të miratojë ndryshimet nga plani i miratuar për furnizimin me mallra, shërbime apo shpenzime të tjera. Është kompetencë e Këshillit Mbikqyrës t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme ndryshimin e këtyre limiteve një herë në vit gjatë miratimit të buxhetit për vitin pasardhës, si edhe sa herë që kjo mund të përbëjë

stimul për rritjen e aktivitetit financiar dhe ekonomik të shoqërisë.

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

- 17.1 Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 17.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e mbajnë postin e tyre për një periudhë prej tre vjetësh, në përfundim të së cilës ata mund të ri-emërohen.
- 17.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë, të cilët duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm. Anëtarë të pavarur të Këshillit Mbikëqyrës vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash apo anëtarësie, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 13 dhe të pikës 3 të nenit 167 të Ligjit **për Shoqëritë Tregtare**. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këto parashikime, është absolutisht i pavlefshëm. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi, e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.
- 17.4 Çdo vend i mbetur vakant në Këshillin Mbikëqyrës si pasojë e dorëheqjes, shkarkimit, paaftësisë apo vdekjes, do të plotësohet nga një anëtar i ri i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Anëtari i ri do të mbetet në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.
- 17.5 Këshilli Mbikëqyrës zgjedh Kryetarin ndërmjet anëtarëve të tij si dhe sekretarin e Këshillit Mbikëqyrës.
- 17.6 Përveç sa përcaktohet në këtë Nen, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të plotësojnë kushtet, detyrimet, përgjegjësitë dhe kriteret e parashikuara në nenet 163 nga (1) në (3) dhe 167 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Procesi Vendimmarrës i Këshillit Mbikëqyrës

- 18.1 Këshilli Mbikëqyrës mund të zhvillojë mbledhjet e tij në Republikën e Shqipërisë, në një vend të caktuar nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës. Nëse nuk caktohet asnjë vend tjetër, Këshilli Mbikëqyrës do të zhvillojë mbledhjet e tij në selinë zyrtare të Shoqërisë.
- 18.2 Këshilli Mbikëqyrës do të mbledhet të paktën gjashtë herë në vit. Çdo mbledhje tjetër e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet me kërkesë të Kryetarit, një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ose të Administratorit.
- 18.3 Mbledhja mund të thirret nga Kryetari, me iniciativën e tij/saj ose me kërkesë të një anëtar i tjetër të Këshillit Mbikëqyrës apo të Administratorit. Si rregull thirrja duhet të bëhet 3 (tre) ditë përpara me leter, faks ose cdo komunikim elektronik të besueshëm, por thirrja mund të jetë e vlefshme edhe verbalisht dhe pa afat, nëqoftë se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës e pranojnë atë. Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.
- 18.4 Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës mbahen në formë dhe në përmbajtjen e përcaktuar në nenin 161 (3) të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 18.5 Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme në rast se më shumë se 1/2 e anëtarëve të tij janë të pranishëm personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve. Nëse ky kuorum nuk arrihet, mbledhja shtyhet për një datë tjetër. Këshilli Mbikëqyrës vendos me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare. Si përjashtim nga ky rregull, Këshilli Mbikëqyrës vendos me unanimitet mbi rregulloren e brendshme të Këshillit.
- 18.6 Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në rastet e parashikuara nga neni 162 (3) i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 18.7 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund gjithashtu të drejtohen nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës, ose nëpërmjet mënyrave të tjera elektronike të ngjashme, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen rregullisht dhe të mund të ndjekin diskutimin dhe të mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në të.
- 18.8 Këshilli Mbikëqyrës mund gjithashtu të marrë vendimet e tij jashtë mbledhjes nëpërmjet komunikimit me shkrim (dorëzuar personalisht, me postë, postë elektronike ose votimit me faks). Në këtë rast, personi që thërret Këshillin Mbikëqyrës i dorëzon (personalisht,

postë, postë elektronike ose faksimile) anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës kopje identike të vendimit të propozuar, ku përmbahen udhëzime të qarta se si anëtarët do të hedhin votën e tyre dhe kthejnë vendimin e nënshkruar. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës shprehin votën e tyre, në përputhje me udhëzimet e projekt vendimit, nënshkruajnë rregullisht kopjen përkatëse dhe e rikthejnë siç udhëzohet në udhëzimet. Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës vendos në lidhje me vendimin e propozuar dhe ia rikthen Shoqërisë brenda 7 (shtatë) ditëve nga data kur vendimi i propozuar i është dorëzuar këtij anëtari, ose përndryshe do të konsiderohet sikur ka marrë pjesë në procedurën e vendimmarrjes dhe ka abstenuar nga votimi në lidhje me vendimin.

Këshilli Mbikëqyrës mund të kërkojë pjesëmarrjen e Administratorit në mbledhjet e tij dhe të kërkojë nga Administratori të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të kryer detyrat dhe përmbushur detyrimet e tij.

c. Administratori.

Administrimi i Shoqërisë

- 19.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i cili autorizohet të ushtrojë të gjitha kompetencat ekzekutive të dhëna nga ligji dhe/ose nga ky Statut.
- 19.2 Administratori zgjidhet nga Këshilli Mbikëqyrës me shumicë të thjeshtë.
- 19.3 Administratori duhet të ketë kombësi Shqipëtare, dhe zgjidhet për një periudhë prej tre vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje.
- 19.4 Në rast se pozicioni i Administratorit mbetet vakant si pasojë e dorëheqjes, shkarkimit, paaftësisë apo vdekjes, atëherë Këshilli Mbikëqyrës do të zgjedhë minimalisht brenda 3 ditëve Administratorin e ri..
- 19.5 Me pranimin e zgjedhjes së tij, Administratori pranon se marrëdhënia e tij me Shoqërinë janë marrëdhënie kontraktuale sipas legjislacionit në fuqi.
- 19.6 Administratori kryen dhe detyra të tjera të cilat mund t'i jepen herë pas here nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Këshilli Mbikëqyrës, në përputhje me këtë Statut dhe me ligjin.


- 19.7 Administratori duhet të zbatojë kriteret, parimet, parashikimet, kufizimet, përjashtimet dhe përgjegjësitë e parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në veçanti me parashikimet e nenit 167 të këtij ligji.

Kompetencat e Administratorit

- 20.1 Administratorit është i ngarkuar me administrimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë.
- 20.2 Administratori do të vendosë për çdo çështje që nuk është kompetencë ekskluzive e Asamblesë e Përgjithshme ose e Këshillit Mbikëqyrës. Në veçanti, Administratori ka kompetencën dhe detyrën që të:
- a. Administronjë Shoqërinë duke zbatuar politikën e saj;
 - b. Të përfaqësojë Shoqërinë në raport me palët e treta;
 - c. Vendosë bashkëpunime jetëgjata biznesi, dhe të propozojë politika në lidhje me formimin e shoqërive ose grupeve të reja;
 - d. Sigurojë mbajtjen dhe administrimin e duhur të librave dhe dokumenteve të kontabilitetit;
 - e. Të kujdeset për përgatitjen, e të nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin dhe raportin e performancës, e t'ia paraqesë ato për miratim Këshillit Mbikëqyrës e më pas Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me propozimin për shpërndarje të fitimeve apo mbulime të humbjeve;
 - f. Krijonjë një sistem monitorimi të hershëm për zhvillime që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - g. Raportonjë pranë Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit dhe për realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
 - h. Kryejë çdo regjistrim ose publikim të të dhënave të Shoqërisë që kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregtare, apo ligje të tjera në fuqi;
 - i. Kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji ose nga ky Statut; dhe

- j. Njoftojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara nga pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 136 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare si:
- (i) Bilancet vjetore ose të përkohshme të Shoqërisë tregojnë ose paraqesin qartësisht mundësinë se humbjet arrijnë deri në 50% të kapitalit të regjistruar, apo se asetet e Shoqërisë nuk do të mbulojnë detyrimet e saj që do të bëhen të kërkueshme brenda 3 muajve të ardhshëm. Në lidhje me këtë çështje, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i pavarur;
 - (ii) ka një propozim për të shitur apo disponuar ndryshe asete të cilat përfaqësojnë më shumë se 5% të aseteve të Shoqërisë ose me vlerë më shumë se 200.000 euro të aseteve të paluajtshme dhe 200.000 euro të aseteve të luajtshme. Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport i një eksperti kontabël të pavarur, përveç kur transaksioni i mësipërm kryhet në tregun e bursës ose si pjesë e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë, të kryera në kushte normale të tregut.
- 20.3 Administratori është i detyruar të marrë miratim paraprak nga Asambleja e Përgjithshme dhe ose Këshilli Mbikëqyrës përpara marrjes dhe/ose zbatimit të ndonjë vendimi në lidhje me çështjet specifike të parashikuara në nenin 13.3 dhe nenin 16.3 të këtij Statuti.
- 20.4 Detyrat, që ligji cakton Këshillit Mbikëqyrës, nuk mund t'i delegohen Administratorit.
- 20.5 Administratori ka të drejtë që Brenda kompetencave të tija t'u japë një ose disapunonjësve të shoqërisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.
- Aktet me të cilat Shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori, ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit përkëto akte.

Struktura Organizative



Arbër AYRAMI
Administratori

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
ALBGAZ Sh.a



III. NDARJA DHE PAVARËSIA E OST

A. Ndarja e OST

10. OST duhet të ndahet nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.

11. OST duhet të jetë një person juridik i ndarë që nuk është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara ose pjesë e strukturës së korporatës dhe nuk kryen dhe as nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të gazit natyror dhe energjisë elektrike.

12. Për të siguruar ndarjen e duhur të OST, i njëjti person ose të njëjtët persona nuk kanë të drejtë që njëkohësisht:

12.1. të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e një të licencuari, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror e të energjisë elektrike, dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo rrjetit të transmetimit;

12.2. të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo të ushtrojnë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike;

12.3. të emërojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ushtrojnë kontroll mbi vendimmarrjen apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror dhe të energjisë elektrike; dhe

12.4. të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të

transmetimit.

13. Të drejtat të cilat referohen në Paragrafin 3 përfshijnë, veçanërisht:

13.1. kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

13.2. kompetencën për të emëruar anëtarët e bordit mbikqyrës, bordit administrativ ose organeve ligjore që përfaqësojnë kompaninë;

13.3. të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve

14. OST mund të funksionojë si një operator i kombinuar sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Nenin 80 të Ligjit Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Në çdo rast, statusi i OST si operator i kombinuar nuk do të ketë efekt në kërkesat për ndarjen dhe pavarësinë e OST të krijuar sipas ligjit nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror dhe këtij Programi. Masat që do të ndërmerren për të përjashtuar sjelljen diskriminuese në lidhje me aktivitetet e tjera të Operatorit të kombinuar që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror duhet të vendosen në një dokument tjetër përputhshmërie të hartuar sipas kërkesave të Ligjit Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror.

B. Pavarësia drejtuese e OST

15. Drejtuesit e OST, të tillë si Anëtarët e bordit mbikqyrës, Anëtarët e Bordit drejtues, menaxheri i përgjithshëm, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njësive strukturore), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, duhet të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

15.1. Drejtuesit e OST nuk duhet të punësohen ose të lidhen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të këtyre;

15.2. Pagat e drejtuesve të OST duhet të vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e OST, si specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit;

15.3. Drejtuesit e OST nuk kanë interes ose marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtperdrejtë ose të tërthortë, për kompanitë vertikalisht të integruara ose

ndonjë pjesë të tyre, me përjashtim të të drejtave të tyre aksionare financiare sipas Paragrafit 15.6;

15.4. Transferimi i drejtuesve të OST tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, duhet të bëhen sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statutet e OST dhe duhet të ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferta nuk duhet të paracaktohen që në fillim;

15.5. OST nuk duhet të ketë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre; dhe

15.6. Drejtuesit e OST nuk duhet të kenë më shumë se 1/5 e aksioneve të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, dhe duhet të shmangin konfliktet e mundshme të interesit që kanë lidhje me këto aksione

C. Pavarësia funksionale dhe vendimmarrëse e OST

16. OST duhet të funksionojë si operator i sistemit të transmetimit për gazin natyror sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

17. Midis të tjerave OST duhet të jetë përgjegjëse për dhënien dhe aksesin e palës së tretë, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve.

18. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, OST duhet të jetë përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re.

19. OST duhet të jetë e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë (këtu dhe më poshtë ERE).

20. OST duhet të mirëmbajë në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për

gazin natyror në përputhje me kërkesat për pavarësinë e tij të vendosura në Paragrafet 16-19 të këtij Programi.

21. Asnjë nga aktivitetet funksionale të OST dhe/ose të drejtat vendimmarrëse nuk mund të ndikohet nga interesat komerciale dhe interesa të tjera të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre.

IV. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE

A. Aksesi në sistemin e transmetimit

22. OST duhet të sigurojë akses të barabartë në sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të cilët përputhen me kërkesat e vendosura tek Ligji Nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

23. OST mund të refuzojë dhënien e aksesit në sistemin e transmetimit vetëm në bazë dhe rastet e përcaktuara tek Ligji Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror”, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

24. Dhënia e aksesit në sistemin e transmetimit ose refuzimin për të dhënë një akses të tillë, si dhe dispozitat për shërbimet e OST nuk duhet të përfundojë në një trajtim preferencial të pjesëmarrësve dhe përdoruesve të rrjetit ose në të kundërt, nuk duhet të jetë diskriminuese ndaj këtyre pjesëmarrësve të vecantë ose përdoruesve të rrjetit.

25. Punonjësit e OST duhet të merren me kërkesën për shërbimet e OST të marra nga pjesëmarrësit ose përdoruesit e rrjetit në mënyrë të drejtë dhe jo-diskriminuese, duke mos favorizuar pjesëmarrësit ose përdoruesit e vecantë të rrjetit që mund të sjellë një avantazh të padrejtë komercial.

26. Paragrafet 24 dhe 25 duhet të zbatohen për prokurimin dhe shitjen e shërbimeve, për çmimin, aksesin ndaj shërbimeve ekskluzive dhe shërbimeve të konsumatorit, duke përfshirë gatishmërinë për ofrimin e shërbimeve të vecanta dhe efikasitetin e tyre.

27. Tarifat dhe detyrimet e tjera për shërbimet e OST duhet të rregullohen sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi dhe duhet të publikohen në faqen e OST dhe të aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit që përmbushin kriteret përkatëse të vendosura në aktet ligjore

në fuqi dhe tek Kodi i Rrjetit të Transmetimit.

B. Konkurenca dhe marrëdhëniet komerciale

28. Aktivitetet e OST nuk duhet të kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror.

29. Çdo transaksion komercial dhe financiar nga OST, përfshirë huatë, kreditë dhe marrëveshjet e tjera financiare, si dhe transaksionet me kompanitë që kanë lidhje duhet të organizohen sipas kushteve të tregut dhe ne asnjë rast ato nuk duhet të ndikojnë negativisht në pavarësinë e OST.

30. OST duhet të njoftojë ERE për transaksionet e mbyllura komerciale dhe financiare duke iu referuar Paragrafit 29 dhe me kërkesën e ERE duhet të ofrojnë kopje të këtyre transaksioneve dhe dokumentave origjinale, ofertave komerciale, deklaratave të pranimit, memorandume, fatura etj.

31. Kopje të të gjitha kontratave të mbyllura nga OST me pjesëmarrësit e tjerë, përdoruesit e rrjetit dhe/ose palëve të tjera të treta dhe dokumenta të tjera origjinale (oferta komerciale, deklarata pranimi, memorandume, fatura etj) duhet të rruhen dhe arkivohen me kujdes tek zyrat e OST dhe duhet të vendosen në dispozicion të zyrtarit të përputhshmërisë të kompanisë OST (këtu dhe më poshtë Zyrtari i Përputhshmërisë").

C. Konflikti i interesit

32. Në rastin e një konflikti ekzistues të interesit ose konflikti të mundshëm, drejtuesi ose punonjësi i OST duhet të informojë në kohë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Zyrtarin e Përputhshmërisë të kompanisë OST, por jo më vonë se dita tjetër e punës, pasi ai/ajo është vënë në dijeni për konfliktin ekzistues të interesit ose ndonjë rrethanë që mund të shkaktojë një konflikt interesit.

33. Konflikti i interesit nënkupton çdo situatë kur ka ndodhur një interes personal i drejtuesit ose punonjësit të OST, qoftë ky konflikt direkt përmes personave që kanë lidhje, ose një konflikt i papërputhshëm me vecimin, pavarësinë, sjelljet e tregut dhe/ose veprimtaritë funksionale të kompanisë OST, ose konflikt në të cilin drejtuesi ose punonjësi i OST është ose mund të jetë në pozicionin për të përfituar nga veprimet ose vendimet e marra si drejtues ose punonjës i OST.

34. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pas njoftimit për konfliktin e interesit, drejtuesi ose punonjësi në fjalë i OST duhet të konsultohet me Drejtuesin e Përgjithshëm ose Zyrtarin e Përputhshmërisë të kompanisë OST, për të shmangur ose eliminuar konfliktin e interesit, ose për të përfunduar marrëdhëniet e punës ose ato profesionale me OST në rast dështimi ose mos-dashjes së menaxherit ose punonjësit për të zgjidhur konfliktin ekzistues ose të mundshëm të interesit.

35. Të gjitha kontratat e punesimit midis OST dhe drejtuesve ose punonjësve, si dhe udhëzimeve profesionale për drejtuesit e emëruar duhet të ofrojnë mundësinë e përfundimit të kontratave të punës ose shkarkimin nga detyra të drejtuesit sipas lirisë së veprimit të kompanisë OST në rast se nuk mund të ndalohej ose zgjidhet konflikti i interesit ose mos-dashjes së drejtuesit ose punonjësit që të zgjidhin konfliktin ekzistues ose konfliktin e mundshëm të interesit.

V. POLITIKA E INFORMACIONIT TË KOMPANISË OST

A. Sigurimi i informacionit

36. OST duhet të sigurojë informacionin funksional dhe informacionin përkatës të sistemit të transmetimit dhe shërbimeve të saj e cila nuk mbrohet si informacion i ndjeshëm tregëtar sipas kushteve dhe termave të akteve ligjore në fuqi dhe këtij Programi. Sigurimi i informacionit duhet të kryhet në mënyrë të drejtë, transparente, dhe jo-diskriminuese. OST duhet të ndalojë sigurimin e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, mund të sjellë avantazhe konkurruese për pjesëmarrësit e vecantë ose përdoruesit e rrjetit. Informacioni publik duhet të publikohet në faqen e internetit të OST, si kërkohet nga Ligji Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror dhe akteve ligjore në fuqi.

37. OST duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm operatorëve të tjerë të sistemit të transmetimit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, operatorëve të sistemit të depozitimit dhe operatorëve të sistemit të GNL për të siguruar rrjedhje të sigurt dhe eficiente të gazit natyror midis sistemeve të ndërlidhura të gazit natyror. Ky informacion duhet të sigurohet sipas termave dhe kushte të përcaktuara tek Ligji Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, akteve ligjore në fuqi dhe kodeve të rrjetit.

38. OST duhet të sigurojë pjesëmarrësve dhe përdoruesve të rrjetit informacionin e nevojshëm për akses eficient dhe të pa-kufizuar tek sistemi i transmetimit. Ky informacion duhet të sigurohet në mënyrë jo-diskriminuese sipas termave dhe

kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

B. Konfidencialiteti i informacionit

39. OST duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të marrë nga OST gjatë aktiviteteve funksionale dhe/ose komerciale, dhe duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të matura për të shmangur informacionin e ndjeshëm tregëtar në lidhje me aktivitetet të cilat përmbajnë vlera tregëtare për persona të tjerë nga shpërndarja diskriminuese.

40. Për qëllime të cilave iu jemi referuar në Paragrafin 39, informacioni i ndjeshëm tregëtar nënkupton:

40.1. Informacioni në lidhje me menaxhimin, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit përveç informacionit publik i përkufizuar si i tillë sipas Ligjit Nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror dhe këtij Programi;

40.2. Informacioni që përmban sekrete tregëtare dhe informacione të tjera të ndjeshme tregëtare të marra nga OST në mënyrë që të kryeje aktivitetet e tij;

40.3. Informacione të tjera të natyrës tregëtare, financiare ose teknike të cilat iu vijnë drejtuesve ose punonjësve të OST gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre profesional, që janë informacione të ndjeshme tregëtare dhe mund të merren nga pjesëmarrës të ndryshëm, ofrohet si një avantazh konkurrenës në tregun e gazit natyror; dhe

40.4. Informationi i klasifikuar si konfidencial ose në konfidencialitet dhe/ose marrëveshjet e fshehta të firmosura nga OST.

41. OST nuk duhet të shpërndajë informacionin e ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë, përveç rasteve kur:

41.1. Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të përcaktuar me ligj.

41.2. Një pëlqim paraprak me shkrim për shpërndarjen e informacion jepet nga personi ndaj të cilit OST është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit; ose

41.3. Kur informacioni nuk është më konfidencial për shkak të shpërndarjes së ligjshme publike të tij.

42. Në rast shpërndarje të informacionit të ndjeshëm tregëtar nga OST për ndonjë palë të tretë sipas kushteve të përcaktuara në Paragrafin 41, kjo shpërndarje duhet të kryhet në masën e nevojshme që OST të sigurojë shërbimet e saj dhe duhet të jetë në përputhje me konfidencialitetin dhe/ose marrëveshjen për të mos e shpërndarë e cila vendos detyrimin e palës së tretë për informacionin konfidencial të marrë nga OST, si dhe vendosjen e detyrimeve financiare për këtë palë të tretë në rast të mos-kryerjes ose zbatimit të papërshtatshëm të detyrimeve konfidenciale.

43. OST duhet të ruajë informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave me furnizuesit e produkteve dhe/ose shërbimeve. Këta furnizues duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre, që e marrin këtë informacion konfidencial nga OST, duhet të mbajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion dhe nuk e shpërndan atë tek ndonjë palë e tretë përvec se kur specifikohet ndryshe në kontratë. Detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit duhet të vazhdojë gjatë gjithë kohës së marrëdhënieve kontraktuale dhe pas mbarrimit të tyre derisa informacioni konfidencial të shpërndahet publikisht në mënyrë ligjore.

44. Drejtuesit ose punonjësit e OST duhet të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Vecanërisht për të siguruar konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar drejtuesit dhe punonjesit e OST:

44.1. Nuk duhet ti lënë materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregëtar sic janë (dokumentat, arkivues të të dhënave elektronike, kompjutera, tableta, telefonat *etj.*) të pa mbrojtur në vende publike;

44.2. Nuk duhet ta diskutojnë informacionin e ndjeshëm tregëtar në publik; dhe

44.3. Kur përdorin postën elektronike ose aplikimet e tjera të komunikimit online, me shumë kujdes duhet të kontrollojnë përmbajtjen e mesazhit dhe adresat e marrësit për të shmangur shpërndarjen e mundshme të informacionit të ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë.

45. Çdo dokument me shkrim i OST që përmban informacion të ndjeshëm tregëtar

duhet të shënohet si i tillë në faqen e parë.

46. Të drejtat e aksesit tek sistemet e informacionit dhe databazat e OST, si dhe të drejtat e aksesit tek disqet dhe dosjet e përbashkëta duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të mos favorizojnë pjesëmarrësit ose përdoruesit e rrjetit. Për këtë arsye, transaksionet online ose aksionet që përbëjnë rrezik për shpërndarjen e informacionit të ndjeshëm tregëtar duhet të tregohen qartë dhe duhet të mbahet një listë për autorizimet e aksesit nga Zyrtari i Përputhshmërisë dhe duhet të përditësohet çdo vit ose më shpesh nëse është e nevojshme.

47. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshillëtarët nuk duhet të shpërndajnë informacionin e ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë gjatë emërimit të tyre, punësimit ose bashkëpunimit me OST dhe të paktën 3 (tre) vitet në vazhdim pas mbarimit të emërimit, punësimit, bashkëpunimit deri kur:

47.1. Pëlqimi paraprak për shpërndarjen të jepet nga personi të cilit OST ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin e informacionit;

47.2. Informacioni nuk është më konfidencial për shkak të shpërndarjes ligjore publike të tij; ose

47.3. Shpërndarja e informacionit kërkohet nga ligji në fuqi.

48. Në rast shpërndarje sipas Paragrafit 47, drejtuesit dhe punonjësit e OST, përfaqësuesit e tyre të autorizuar, audituesit dhe këshillëtarët janë të detyruar të sigurojnë që informacioni i ndjeshëm tregëtar është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit në të njëjtën kohë për të mos i dhënë asnjë personi një avantazh të padrejtë tregëtar në tregun e gazit natyror.

49. Në përputhje me kërkesat e transparencës të kompanisë OST, duhet të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e OST. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregëtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në faqen e internetit të OST.

50. Marrëveshjet konfidenciale me drejtuesit e emëruar të OST, kontratat e punësimit

me punonjësit e OST, si dhe marreveshjet e mbyllura midis OST dhe përfaqësuesve të saj të autorizuar, audituesve dhe këshilltarëve duhet tu ofrojë drejtuesve, punonjësve, përfaqësuesve të autorizuar audituesve dhe këshilltarëve detyrimet që kanë lidhje me konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar dhe duhet të vendosë detyrimet financiare në rast të moskryerjes ose zbatimit të papërshtatshëm të këtyre detyrimeve.

51. Çdo prishje e detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar, si kërkohet sipas këtij Programi dhe kontratave respektive, mund të quhet shkelje e madhe e detyrimeve të drejtuesve, punonjësve, përfaqësuesve të autorizuar, audituesve ose këshilltarëve, dhe mund ti japë OST të drejtën për të kërkuar kompensimin e dëmit.

C. Informacioni publik

52. Informacion publik nënkupton çdo informacion që përgjithësisht njihet se ka një karakter publik, ose çdo informacion tek i cili aplikohen kërkesat për shperndarjen e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi. Ky informacion nuk mund të klasifikohet si konfidencial ose informacion i ndjeshëm tregëtar dhe duhet të vendoset në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të tjera të treta.

53. OST duhet të publikojë në faqen e internetit informacionin e mëposhtëm:

53.1. Listën e shërbimeve të ofruara nga OST, informacion për tarifatat dhe kushtet e tjera për sigurimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë kushtet teknike për aksesin dhe lidhjen me sistemin e transmetimit;

53.2. Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të transmetimit për pikat hyrëse dhe dalëse dhe metodologjinë për përcaktimin e tarifës së lidhjes për lidhjen me sistemin e transmetimit;

53.3. Informacionet shifrore për vëllimet e kapacitetit teknik, kapacitetit të kontraktuar dhe kapacitetit në dispozicion të sistemit të transmetimit në lidhje me pikat hyrëse dhe dalëse në bazë mujore;

53.4. Të dhëna për vëllimet e planfikuara dhe ato aktuale të gazit natyror që do të transportohet nëpërmjet sistemit të transmetimit; dhe

53.5. Informacione të tjera të specifikuar në Ligjin Nr. 102/2015 Për Sektorin e

Gazit Natyror, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

54. OST duhet të arkivojë informacionin të cilit i jemi referuar në Paragrafin 53 për 5 (pesë) vjet nga data kur ai është vendosur dhe duhet ta rinxjerrë atë me kërkesen e autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

VI. ZBATIMI I PROGRAMIT

A. Karakteri detyrues i Programit

55. Dispozitat e këtij Programi janë të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit dhe në rastet referuar këtij Programi dhe kontratave të mbyllura nga OST ose tek aktet ligjore në fuqi, zbatimi i dispozitave të caktuara të këtij Programi është detyrues për përfaqësuesit e autorizuar të OST, për audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

56. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët duhet të konfirmojnë me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta zbatojnë atë. Në rast ndryshimesh ose amendimesh të Programit, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur drejtuesit e OST, punonjësit, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit, dhe këshilltarët për përmbajtjen e këtyre ndryshimeve ose amendimeve dhe drejtuesit përkatës, punonjësit, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët duhet të konfirmojnë me shkrim që ata janë njoftuar në kohë për këto ndryshime dhe amendime të Programit.

57. Të gjithë drejtuesit e OST, dhe punonjësit duhet të udhëzohen rregullisht për zbatimin e këtij (të paktën një herë në vit). Drejtuesit e rinj dhe punonjësit duhet të udhëzohen para se të fillojnë mandatin e tyre ose para se të punësohen. Udhëzimet duhet të jepen nga Zyrtari i Përputhshmërisë.

58. Nëse drejtuesit ose punonjësit e OST vihen në dijeni për shkeljen e ndonjë dispozite të Programit drejtuesi ose punonjësi duhet të informojë menjëherë Zyrtarin e Përputhshmërisë.

59. Shkelja e ndonjë dispozite të Programit mund të cilësohet si shkelje e detyrimeve nga drejtuesi, punonjësi, përfaqësuesi i autorizuar, audituesi ose këshilltari dhe mund ti japë OST të drejten për të zbatuar veprimet disiplinore sipas termave dhe kushteve të

përcaktuara tek aktet ligjore në fuqi dhe kontratat respektive dhe/ose aktet e brendshme të kompanisë OST.

B. Monitorimi i zbatimit të Programit

60. Monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin sic duhet të Programit duhet të kryhet nga Zyrtari i Përputhshmërisë i cili duhet të funksionojë në bazë dhe sipas kompetencave të ofruara sipas Ligjit Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kontratës së lidhur midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë.

61. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë OST, si specifikohet në Paragrafin e Nenit 47 Ligji Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror”, pas miratimit paraprak nga ERE. Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse duhet të vendosen nga Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë OST dhe të miratohen nga ERE. Së bashku me kandidimin për Zyrtar Përputhshmërie, OST duhet ti ofrojë ERE detajet për pavarësinë dhe përputhjen e kandidatit me kërkesat minimale për kriteret profesionale dhe kriteret e tjera përzgjedhëse.

62. Kontrata midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë duhet të përshijë kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe të këtij Programi, dhe duhet të nënshkruhet pas miratimit paraprak nga ERE. Për këtë qëllim OST duhet ti ofrojë ERE të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për të arsyetuar përputhshmërinë me kërkesat përkatëse.

63. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të jetë i pavarur gjatë kryerjes së detyrës së tij. Për këtë qëllim:

63.1. Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë edhe operatorin e kombinuar, sipas rastit);

63.2. Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të ketë kryer asnjë detyrë tjetër profesionale dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë

funksion tjetër ose të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve për një periudhë prej të paktën 3(tre) vjet para emërimit si Zyrtar i Përputhshmërisë për kompaninë OST;

63.3. Pas mbarimit të marrëdhënieve kontraktuale me OST, Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore të kryejë ndonjë funksion ose të marrë pjesë në biznese ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e aksioneve të saj, ose me ndonjë kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë operatorin e kombinuar, sipas rastit) për një periudhë prej jo më pak se 4 (katër) vjet; dhe

63.4. Zyrtari i Përputhshmërisë nuk duhet të ketë interes ekonomik ose të marrë përfitime financiare, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthore, nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre, ose nga kompanitë që kanë lidhje me aktivitetin e gazit natyror, përveç transmetimit të gazit natyror (duke përfshirë operatorin e kombinuar, sipas rastit).

64. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm si dhe kushtet e duhura financiare dhe organizuese që të mundësojnë, *midis të tjerash*, propozimin e masave për të siguruar zbatimin e këtij Programi dhe të kërkojë bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit e OST kur verifikon dhe siguron përputhshmërinë me këtë Program.

65. PAGESA E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË NUK DO TË BAZOHET TEK VLERËSIMET E PERFORMANCËS NGA DREJTUESI I OST. Politikat për këtë pagesë duhet të përgatiten në mënyrë të qartë në kontratën midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë.

66. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë akses tek të dhënat e nevojshme dhe në zyrat e OST dhe tek gjithë informacioni që duhet për të kryer detyrat e tij. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë akses në zyrat e OST pa njoftimin paraprak.

67. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e drejtuesve të OST dhe organeve korporative, përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikqyrëse dhe drejtuese, të cilat janë të detyruara të informojnë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara dhe duhet të sigurojnë të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në

takime. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të marrë pjesë në të gjitha takimet të cilat adresojnë çështjet në vijim:

67.1. kushtet për aksesin në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, në veçanti në lidhje me çmimet dhe shërbimet për të patur akses në sistemin e transmetimit dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit, si dhe në lidhje me alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

67.2. projektet e ndërmarra për të menaxhuar sistemin e transmetimit dhe për të mirëmbajtur e zhvilluar rrjetin e transmetimit, përfshirë investimet në linjat ndërkufitare të interkoneksionit dhe lidhjet; dhe

67.3. blerjet ose shitjet e energjisë të nevojshme për funksionimin e sistemit të transmetimit, përfshirë shërbimet ndihmëse dhe shërbimin e balancimit.

68. Përveç të drejtave të përcaktuara në Paragrafin 67, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të ketë të drejtën të marrë pjesë tek të gjitha takimet e organeve korporative të OST, tek takimet e drejtuesve ose punonjësve duke përfshirë edhe takimet funksionale. Drejtuesit përgjegjës dhe/ose punonjësit duhet të njoftojnë Zyrtarin e Përputhshmërisë për takimet e programuara ose jo.

69. Për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e këtij Programi dhe përmbushjen e detyrave, Zyrtari i Përputhshmërisë vecanerisht duhet të jetë përgjegjës për:

69.1. monitorimin e zbatimit të këtij Programi;

69.2. përpunimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e këtij Programi dhe dërgimin e saj në ERE;

69.3. raportimin në organet përgjegjëse korporative të OST dhe dhënien e rekomandimeve për këtë Program dhe zbatimin e tij;

69.4. investigimin dhe raportimin tek organet përgjegjëse korporative të OST për çfarëdo shkelje të pretenduar në lidhje me zbatimin e këtij Programi, dhe paraqitjen e zgjidhjeve të propozuara për masat e nevojshme korrigjuese;

69.5. investigimin e konfliktit ekzistues ose të mundshëm të interesit për drejtuesit dhe punonjësit e OST, ofrimi i konsultimeve për të parandaluar konfliktet e

mundshme të interesit dhe korigjimin e konfliktit ekzistues të interesit, si dhe zgjidhjet që propozohen për masat e nevojshme korigjuese;

69.6. njoftimi i ERE për shkeljet në lidhje me zbatimin e këtij Programi;

69.7. raportimi në ERE për marrëdhëniet tregëtare dhe/ose financiare midis OST dhe kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e tyre;

69.8. paraqitja e propozimeve për organet përgjegjëse të OST, sipas miratimit paraprak nga ERE në lidhje me planin 10-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit ose investimeve individuale në rrjetin e transmetimit;

69.9. monitorimi i përputhshmërisë së OST me dispozitat e Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe këtij Programi duke rregulluar konfidencialitetin në aktivitetet e kompanisë OST;

69.10. monitorimi i ndryshimeve legislative dhe rregullatore në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e këtij Programi;

69.11. ofrimi i konsultimeve në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve të brendshme të kompanisë OST dhe pasqyrimi i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore në këto akte;

69.12. përgjigja e pyetjeve të drejtuesve dhe punonjësve të OST në lidhje me këtë Program;

69.13. udhëzimin e drejtuesve dhe punonjësve të OST për këtë Program, zbatimin e tij dhe kur është e përshtatshme ndryshimet e tij të përcaktuara në Paragrafin 57;

69.14. koordinim i komunikimit me ERE, autoritetet e tjera kompetente, pjesëmarrësit dhe ose palët e treta që kanë lidhje me zbatimin e këtij Programi.

70. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të japë opinion në lidhje me ndonjë dokument të brendshëm ose veprim të OST në lidhje me përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore në fuqi, duke përfshirë ndryshimet ligjore dhe rregullatore në fjalë dhe me këtë Program.

71. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të refuzojë udhëzimet ose kërkesën e OST,

organeve korporative, të drejtuesve, punonjesve dhe ose ndonjë përfaqësuesi të cilat janë ose ka mundësi të jenë në konflikt me mandatin dhe/ose pavarësinë e Zyrtarit të Përputhshmërisë.

72. Zyrtari i Përputhshmërisë mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës i OST, si specifikohet në Paragrafin 11 Neni 47 i Ligjit Nr 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", pas miratimit paraprak nga ERE.

C. Raportimi për zbatimin e Programit

73. Çdo vit, jo më vonë se data [31 Mars], Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST dhe të ERE.

74. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të dorëzojë një raport të cilit i jemi referuar në Paragrafin 73 Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

75. Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të raportojë rregullisht, me gojë ose me shkrim, te organet përkatëse korporative të OST në lidhje me zbatimin e këtij Programi.

VII. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

76. Ky program duhet të miratohet me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të kompanisë OST dhe, brenda 5 (pesë) ditëve pas përshtatjes së tij ky vendim duhet të dorëzohet në ERE për miratim. Ky Program duhet të hyjë në fuqi ditën tjetër pas miratimit nga ERE.

77. Çdo ndryshim i këtij Programi duhet të pranohet dhe të hyjë në fuqi si specifikohet në Paragrafin 76.